



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 59

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
MAT, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Mat

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Mat për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Bashkia Mat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 24.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 28.1.2025, ora 10:00, me tematikë “Inagurim”, “Arsim”, “*Bashkia Mat në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë në muajin qershor 2024 ka nisur investimin për Rikonstruksionin e plotë të qendrës Rinore Mat "Rinovart"*”.

Data: 31.1.2025 Nr: 59
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Mat për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Mat, një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Mat ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Ilogaria si raportues në sistem për Bashkinë Mat është krijuar në datën 24.01.2025, në këto kushte menjëherë pas aksesimit në llogari, është bërë raportimi i aktivitetit të planifikuar”*.

Në përfundim të shqyrtimit, pas verifikimit në NRI, konfirmohet se regjistrimi i personit përgjegjës për raportim i Bashkisë Mat është bërë në datën 24.1.2025. Për këtë arsye Bashkia Mat nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për raportimin e veprimtarive. Në këtë rast mirëkuptohet situata dhe nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Mat.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI